



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 471/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Arifaj” shpk, “Vëllezërit Hysa” shpk, “Sireta” shpk, “GPG” shpk dhe “Hastoci” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-68688-08-13-2020, me objekt “*Rikualifikim Urban i Unazës së Re Berat*” me fond limit 666.656.386 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

BOE “Curri” shpk& “Xhengo” shpk
Rruga “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap.3, Njësia
Bashkiake Nr.10 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 13.08.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-68688-08-13-2020, me objekt “*Rikualifikim Urban i Unazës së Re Berat*” me fond limit 666.656.386 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e

gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 16.09.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 18.09.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Arifaj	340,036,697	I kualifikuar
- S.M.O.UNION	349,496,403	I skualifikuar
- K-AAV	367,346,208	I skualifikuar
- VELLEZERIT HYSA	406,109,682	I kualifikuar
- S I R E T A 2F	411,111,111	I kualifikuar
- G.P.G. COMPANY	444,861,154	I kualifikuar
- HASTOÇI	476,145,492.1	I kualifikuar
- CURRI	490,166,348.56	I kualifikuar
- ALB-BUILDING	494,201,957.88	I kualifikuar
- AGI KONS	500,631,708	I kualifikuar
- 2 T	548,280,997.85	I kualifikuar
- BESTA	570,800,741	I kualifikuar
- PE - VLA – KU	585,986,403.21	I kualifikuar
- "GENER 2"	646,889,526.75	I kualifikuar

II.4. Në datën 25.09.2020 BOE “Curri” shpk& “Xhengo” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Sipas njoftimit të klasifikimit vërehet se në vend të parë është kualifikuar oferta e paraqitur nga Arifaj shpk. Sipas këtij njoftimi janë kualifikuar edhe ofertat e paraqitura nga Vëllezrit Hysa shpk, Sireta shpk, GPG shpk, Hastoci shpk.
- Me sa duket duke kualifikuar e klasifikuar në vend të parë ofertën më të ulët KVO ka bërë një vlerësim sipërfaqësor të përmbushjes së kritereve për kualifikim.
- Nqs se nga KVO do të ishte kryer i plotë shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili prej operatorëve të renditur më poshtë se oferta e BOE Curri shpk&Xhengo shpk atherë do duhej të skualifikonte këtë operatorë sepse dokumentacioni i paraqitur

prej tyre nuk fëshmon plotësimin e të gjithë kriterëve për kualifikim të kërkuar në shtojcën 12 të DT.

- Këta operatorë duhet të ishin skualifikuar sepse nuk i përmbushin disa nga kriteret e vecanta për kualifikim.
- Kështu operatorët Arifaj shpk, Vëllezrit Hysa shpk, Sireta shpk, GPG shpk, Hastoci shpk nuk kanë paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar nga AK në DT për të dëshmuar plotësimin e çdo kriteri për kualifikim.
- Kështu operatorët e sipërcituar nuk plotësojnë pikën 2.3.2 ku është kërkuar:
Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 210 punonjës për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020, e vërtetuar kjo me:
Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Prill 2020 - Korrik2020.
Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020.
Duke mos e plotësuar këtë kriter në numrin e kërkuar në periudhën e kërkuar prill korrik 2020 këta operatorë nuk japin garanci dhe nuk tregojnë besueshmëri për AK se do ta përmbyllin me sukses realizimin e kontratës.
- Asnjë prej operatorëve nuk ka inxhinierët e kërkuar si pjesë e stafit teknik që do të angazhojë gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës duke mos dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.3 ku është kërkuar
Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, certifikimet
Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
Stafi Kryesor	
1 (një)	Inxhinier Ndertimi – si Drejtues Projekti gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Inxhinier Ndertimi me profilin Transport gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Inxhinier Elektrik - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Inxhinier Mjedisi - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
Stafi Mbështetës	
1 (një)	Inxhinier Mekanik gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Topograf/Gjeodet - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës

1 (një)	Arkitekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës
1 (një)	Inxhinier Gjeolog gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës

Duke qenë se operatorët e mësipërm nuk e dëshmojnë se e disponojnë këtë staf teknik atherë kjo përbën shkak për skualifikim të sejcilit prej tyre.

- *Operatorët e sipërcituar nuk kanë arritur të dëshmojnë plotësimin e pikës 2.3.5 ku është kërkuar:*

2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi
1	Eskavator me zinxhirë	Cope	4
2	Eskavator me goma	Copë	3
3	Minieskavator	Copë	4
4	Buldozer	Copë	1
5	Fadrome Kove perpara dhe mbrapa	Copë	2
6	Grejder	Copë	2
7	Bobcat	Copë	2
8	Mjet autovinç deri ne 20 ton	Copë	1
9	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 30 ton	Copë	6
10	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton	Copë	2
11	Kamion veteshkarkues 5 – 10 ton	Copë	2
12	Impiant betoni	Copë	1
13	Gurethyes frontoje	Copë	1

14	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Copë	2
15	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Copë	2
16	Rrul hekuri (kapaciteti jo me pak se 4 ton)	Copë	2
17	Kompresor	Copë	1
18	Auto bitumatrice	Copë	1
19	Autobot uji me sprucator	Copë	2
20	Freze asfalti	Copë	1
21	Autobetoniere	Copë	3
22	Autopomp betoni	Copë	1
23	Asfaltoshtruese	Copë	1
24	Gjenerator	Copë	1

Duke qenë se nga operatorët e kualifikuar nuk dëshmohet disponimi i sigurt i numrit e llojit të mjeteve e makinerive të kërkuara në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta atëherë këta operatorë duhet të ishin skualifikuar.

Theksojmë gjithashtu se për mjetet me goma e që rregjistrohen në rregjistrat publikë nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë sic është kërkuar në DT.

Edhe në rastin e BOE vlerësimi nga KVO duhej të ishte bërë mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 74 të VKM nr.914/2014 duke vlerësuar nëse operatorët i plotësojnë kriteret për kualifikim në përputhje e sipas natyrës e përqindjes së ndarjes së punimeve që kanë bërë në akt marrëveshjen noteriale të bashkëpunimit.

Duke qenë se jemi pjesmarrës në këtë procedurë e kemi interes për ta fituar atë e meqënëse sic shpjeguam më sipër operatorët Arifaj shpk, Vëllezrit Hysa shpk, Sireta shpk, GPG shpk, Hastoci shpk nuk kanë paraqitur të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT për të dëshmuar plotësimin e cdo kriteri për kualifikim nëpërmjet kësaj ankese kërkojmë:

AK të bëjë rivlerësim të procedurës dhe të bëjë shqyrtim të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga cdo ofertues pjesmarrës duke skualifikuar ofertën e Arifaj shpk, Vëllezrit Hysa shpk, Sireta shpk, GPG shpk, Hastoci shpk

II.5. Në datën 02.10.2020 me shresën nr.2212/1 prot BOE ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 09.10.2020 pala ankimuese BOE “Curri” shpk& “Xhengo” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.2479/1 prot datë 20.10.2020 protokolluar me tonën me nr.1251/2 prot datë 21.10.2020 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” shpk& “Xhengo” shpk mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Hastoci” shpk& “BE-IS” shpk me argumentin se *Kështu operatorët e sipërcituar nuk plotësojnë pikën 2.3.2 ku është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 210 punonjës për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020, e vërtetuar kjo me:*

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Prill 2020 - Korrik 2020.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020.

Duke mos e plotësuar këtë kriter në numrin e kërkuar në periudhën e kërkuar prill korrik 2020 këta operatorë nuk japin garanci dhe nuk tregojnë besueshmëri për AK se do ta përmbyllin me sukses realizimin e kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Hastoci” shpk dhe “BE-IS “ shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë nëpërmjet Kontratës për Bashkimin e Përkohshëm të Operatorëve me nr.3559 rep nr.1779 kol datë 16.09.2020 për realizimin e objektit ‘*Rikualifikim Urban i Unazës së Re Berat*’.

Përqindja e kryerjes së punimeve sipas kontratës së bashkëpunimit do të jetë shoqëria “Hastoci” shpk do të realizojë 50 % të vlerës së punimeve sipas ndarjes të zërave të punimeve në preventiv ofertën që do paraqitet në tender preventiv i cili i bashkëngjitet kësaj kontrate bashkëpunimi.

Shoqëria “BE-IS” shpk do të realizojë 50% të vlerës së punimeve sipas ndarjes së bërë të zërave të punimeve në preventiv ofertën që do paraqitet në tender preventiv i cili i bashkëngjitet kësaj kontrate bashkëpunimi.

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën 210 punonjës për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020, e vërtetuar kjo me:

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Prill 2020 - Korrik2020.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE “Hastoci” shpk dhe “BE-IS “ shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim NR.T02833821 datë 09.09.2020 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a e subjektit Hastoci shpk nga ku rezulton se mesatarja e punonjësve për periudhën prill 2020-Korrik 2020 është 168.5.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën prill 2020-Korrik 2020.
- Vërtetim Nr.T02776130 datë 28.08.2020 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a e subjektit BE-IS shpk nga ku rezulton se mesatarja e punonjësve për periudhën prill 2020-Korrik 2020 është 130.75.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën Janar 2019-Korrik 2020.

III.1.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 i ndryshuar parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.6. Në nenin 26 pika 8 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose
b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose
c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë Hastoci shpk & BE-IS shpk në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me numrin mesatar të punonjësve për periudhën prill 2020-korrik 2020 gjykon se numri i kërkuar i punonjësve përmbushet dhe madje tejkalohet nga të dy anëtarët e bashkimit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Konkretisht në bazë të kontratës së bashkëpunimit secili prej anëtareve të bashkimit duhet të dëshmojë se ka të punësuar për periudhën Prill-Korrik 2020 një numër prej 105 punonjësish. Rezulton se anëtari i bashkimit të operatoreve ekonomikë “Hastoci” shpk ka një numër mesatar prej 168.5 ndërsa anëtari tjetër i bashkimit rezulton të ketë një punësim mesatar prej 130.75 punonjësish. Në këtë kuptim kriteri lidhur me numrin e punonjësve përmbushet tërësisht nga BOE “Hastoci” shpk & “BE-IS” shpk.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Curri” shpk & “Xhengo” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e BOE “Curri” shpk & “Xhengo” shpk për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Arifaj” shpk, “Vëllezërit Hysa” shpk, “Sireta” shpk, “GPG” shpk me argumentin se *“Operatorët e sipërcituar nuk plotësojnë pikën 2.3.2 ku është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 210 punonjës për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020, e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Prill 2020 - Korrik 2020. Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2020 – Korrik 2020. Duke mos e plotësuar këtë kriter në numrin e kërkuar në periudhën e kërkuar prill korrik 2020 këta operatorë nuk japin garanci dhe nuk tregojnë besueshmëri për AK se do ta përmbyllin me sukses realizimin e kontratës”*, Komisioni sqaron se,

III.2.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe *ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.2.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.2.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi s’kualifikimin e BOE “Hastoci shpk & “BE-IS shpk të palës ankimuese, Komisioni i

Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qendrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe gjendja faktike juridike e BOE “Hastoci shpk & “BE-IS shpk mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” shpk& “Xhengo” shpk mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Arifaj” shpk, “Vëllezërit Hysa” shpk, “Sireta” shpk, “GPG” shpk dhe “Hastoci” shpk me argumentat se *Asnjë prej operatorëve nuk ka inxhinierët e kërkuar si pjesë e stafit teknik që do të angazhojë gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës duke mos dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.3 ku është kërkuar*

Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, certifikimet

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
Stafi Kryesor	
1 (një)	<i>Inxhinier Ndertimi – si Drejtues Projekti gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Inxhinier Ndertimi me profilin Transport gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Inxhinier Hidroteknik gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Inxhinier Elektrik - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Inxhinier Mjedisi - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
Stafi Mbështetës	
1 (një)	<i>Inxhinier Mekanik gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Topograf/Gjeodet - për çdo objekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Arkitekt gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>
1 (një)	<i>Inxhinier Gjeolog gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës</i>

Duke qenë se operatorët e mësipërm nuk e dëshmojnë se e disponojnë këtë staf teknik atherë kjo përbën shkak për skualifikim të sejcilit prej tyre.

- *Operatorët e sipërcituar nuk kanë arritur të dëshmojnë plotësimin e pikës 2.3.5 ku është kërkuar:*

2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi
1	Eskavator me zinxhirë	Cope	4
2	Eskavator me goma	Copë	3
3	Minieskavator	Copë	4
4	Buldozer	Copë	1
5	Fadrome Kove perpara dhe mbrapa	Copë	2
6	Grejder	Copë	2
7	Bobcat	Copë	2
8	Mjet autovinç deri ne 20 ton	Copë	1
9	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 30 ton	Copë	6
10	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton	Copë	2
11	Kamion veteshkarkues 5 – 10 ton	Copë	2
12	Impiant betoni	Copë	1
13	Gurethyes frontoje	Copë	1
14	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 12 ton)	Copë	2
15	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Copë	2
16	Rrul hekuri (kapaciteti jo me pak se 4 ton)	Copë	2
17	Kompresor	Copë	1
18	Auto bitumatrice	Copë	1

19	Autobot uji me sprucator	Copë	2
20	Freze asfalti	Copë	1
21	Autobetoniere	Copë	3
22	Autopomp betoni	Copë	1
23	Asfaltoshtruese	Copë	1
24	Gjenerator	Copë	1

Duke qenë se nga operatorët e kualifikuar nuk dëshmohet disponimi i sigurt i numrit e llojit të mjeteve e makinerive të kërkuara në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta atëherë këta operatorë duhet të ishin skualifikuar.

Theksojmë gjithashtu se për mjetet me goma e që rregjistrohen në rregjistrat publikë nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë sic është kërkuar në DT.

Edhe në rastin e BOE vlerësimi nga KVO duhej të ishte bërë mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 74 të VKM nr.914/2014 duke vlerësuar nëse operatorët i plotësojnë kriteret për kualifikim në përputhje e sipas natyrës e përqindjes së ndarjes së punimeve që kanë bërë në akt marrëveshjen noteriale të bashkëpunimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe 2.3.5 në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve nga 5 operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3.2. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.3.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve.

Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kritereve.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurizimin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të

gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikon se: *“Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”*, ndërkohë në nenin 25 të tij parashikohet se *“Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”*.

III.3.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.3.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Curri” shpk& “Xhengo” shpk për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr.REF-68688-08-13-2020, me objekt *“Rikualifikim Urban i Unazës së Re Berat”* me fond limit 666.656.386 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1251 Protokolli, Datë 09.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri